



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 159, Datë 17.06.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBTEK ENERGY” SH.P.K. PËR PËRCAKTIMIN E
ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA IMPIANTI I
TRAJTIMIT TË MBETJEVE URBANE NË QYTETIN E ELBASANIT**

Në mbështetje të neneve 10, pika 2, 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.03.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; VKM-së nr. 907, datë 17.12.2014 “Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë”; VKM-së nr. 792, datë 09.11.2016, “Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, shoqërisë “Albtek Energy sh.p.k.” dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.06.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 925/7 prot., datë 15.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga impianti i trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. me shkresën e datës 10.05.2022, protokolluar në ERE me nr. 165/6 prot., datë 12.05.2022, ka kërkuar përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane me fuqi të instaluar 2850 KW, duke përcjellë kostot faktike të ndërtimit dhe operimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, mbështetur në të dhënat paraprake të vëna në dispozicion nga zyra e kontabilitetit.
- Me anë të kësaj shkrese, shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. gjithashtu ka bërë me dije se:
 - Shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. është sekuestruar me vendimin nr. 484, datë 13.12.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe për administrimin e saj është caktuar një administrator nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, pranë Ministrisë së Brendshme.

- Gjatë administrimit të kësaj shoqërie, nga dokumenti financiar i vënë në dispozicion nga shoqëria “Consulting SE Partners” sh.p.k. e cila mban regjistrat kontabël të shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k. u konstatua se është e nevojshme përcaktimi i çmimit të energjisë elektrike të prodhuar deri në momentin e marrjes në administrim nga ana e saj.
- Nga konstatimi i dokumentacionit financiar të vënë në dispozicion nga shoqëria “Consulting SE Partners” sh.p.k., u konstatua se kjo shoqëri nuk ka mjetet e duhura financiare për vazhdimin e punës në impiantin e depozitimit të mbetjeve në qarkun e Elbasanit. Gjithashtu, përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike do të ndihmonte procesin e mbylljes së bilanceve përgjatë transferimit të këtij impianti tek bashkia Elbasan.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 797/2 prot., datë 06.06.2022, ka kërkuar nga ERE trajtimin e kërkesës së subjektit për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në Elbasan, nga shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k., referuar kostove të operimit të impiantit, sipas dispozitave ligjore dhe kompetencave të ERE-s.
- Me shkresën e datës 14.06.2022, protokolluar në ERE me nr. 165/8 prot., datë 14.06.2022, shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. ka bërë me dije se: “Përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga impianti i përpunimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit, sikurse kërkuar edhe nga MIE me shkresën nr. 797/2 prot., datë 06.06.2022, do t’i jepte zgjidhje problematikës së krijuar dhe si rrjedhojë do të sillte përfundimin e procesit gjyqësor midis ERE dhe Albtek Energy”.
- Me paraqitjen e kostove faktike të ndërtimit dhe operimit të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit nga shoqëria “Albtek Energy” sh.p.k. nëpërmjet shkresës së datës 10.05.2022, protokolluar në ERE me nr. 165/6 prot., datë 12.05.2022 dhe në vijim të konsultimeve me Autoritetin Kontraktor (MIE), vlerësojmë se janë përmbushur kushtet e nevojshme për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në Elbasan bazuar në kostot e operimit të impiantit.
- Në zbatim të VKM-së nr. 907, datë 17.12.2014 *“Për dhënien e miratimit për sigurimin e financimit të nevojshëm të kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë”* si dhe kontratës së koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim - Operim - Transferim) për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit, të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “Albtek Energy” sh.p.k., ERE ka detyrimin e miratimit të çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga koncesionari për të gjithë afatin e marrëveshjes koncesionare, siç përcaktuar në nenin 5.2.1, gërma “d”, pika (iii) të kësaj kontrate.
- Metoda përlllogaritëse e përdorur për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane në Elbasan do të jetë bazuar në kostot e operimit ashtu si orientuar edhe nga MIE, duke përlllogaritur kostot e operimit për sa i takon aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, si dhe duke njohur një përqindje fitimi mbi kostot e operimit për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë, metodë kjo gjerësisht e njohur dhe përdorur nga rregullatorët në përcaktimin e çmimeve apo tarifave (metoda kosto plus).

- Prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga impianti i trajtimit të mbetjeve urbane në Elbasan është llogaritur të jetë sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 792, datë 09.11.2016 “Për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impiantit me rikuperim të energjisë nga trajtimi i mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit, shoqërisë “Albtek Energy sh.p.k.”.
- Nga përlllogaritja e shpenzimeve vjetore të operimit të pranuar nga ERE, normës së fitimit të pranuar dhe prodhimit vjetor të energjisë elektrike të parashikuar sipas VKM-së nr. 792, datë 09.11.2016, çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impianti i trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit rezulton të jetë 5.77 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 5.77 lekë/kWh, për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti i trajtimit të mbetjeve urbane në qytetin e Elbasanit me kapacitet të instaluar 2850 KW, përgjatë gjithë periudhës së marrëveshjes së koncesionit.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI